

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Pergjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] te cilën e perfaqëson me autorizim av. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] kundër te paditues KS [REDAKTUAR]” me seli në [REDAKTUAR] te cilën e perfaqëson me autorizim [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], për shpërblim dëmi material dhe jomaterial, në seancën e mbajtur me datë 26.08.2013, në prezencën e te autorizuarëve të palëve ndërgjyqjësë, në të njëjtën ditë, muarr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar, kërkesëpadija e paditëses [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe **OBLIGOHET** e paditura KS “ [REDAKTUAR] Sh.A.- [REDAKTUAR], që paditëses në emër shpërblimit të dëmit të pësuar, t’ia paguaj shumat si vijojnë:

**1. në emër të dëmit jomaterial:**

- për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej 3.500.00 €,
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.500,00 €,
- për shëmtimin trupor shumë prej 1.100,00 €
- për zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumë prej 7.000.00€

**2. në emër të dëmit material:**

- për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumë prej 280.00 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150.00 €

...e që kur paditëses nga shumat e përgjithshme e shpërblimit të dëmit prej 14,234.40 €, i zbritet pjesa e kontributit të saj në shkaktimin e aksidentit-dëmeve në shkallën prej 20%, i bie **11.378.52€ (njembedhjetmijetreqindeshatetëdhjetetëeuro pesëdhjetëdycenteuro)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t’ia paguaj së bashku me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartesisë që zbatohet bankat vendore për kursimet e afatizuara të qytetarëve në periudhë njëvjeqare, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë 27.05.2013 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej 804.40 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishëmrisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbairimit me dhuën.

**REFUZOHET**, pjesa e kërkesëpadiës, përtej lartesisë së shumave të aprovuara.

### **A r s y e t i m i**

Paditësja me padi dhe parashtrimet e mbajtura, përmes të autorizuarit të saj, ka pretenduar se për shkak të aksidentit të që ka nodhur me datë 31.08. 2012, ku për shkak të veprimeve të kundërligjshme të të siguarit të të paditurës identifikuar nën policën e sigurimit nr.0004404127 “ [REDAKTUAR]”, i siguarit i të paditurës i ka shkaktuar lëndime trupore të natyrës së rëndë. Ka pretenduar se e paditura është përgjegjëse mbi bazën e ligjit për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve, për veprimet e paligjshme të të siguarit të saj nga të cilat veprime të paditurës I janë shkaktuar dëme të natyrës material dhe jomateriale, të cilat janë vërtetuar edhe

mbi bazën e ekspertizave mjekësore. Ka theksuar se pranojnë pjesën e kontributit të paditësen në shkaktimin e aksidentit të datës 31.08.2012 në shkallen prej 20%.

I ka propozuar gjykates që të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses sipas lartesisë së precizuar me datë 09.08.2013 si dhe ka kërkuar shpenzimet e kësaj procedure sips tarifës së avokateve.

E paditura, permes perfaqesuesit te saj, ne përgjigje në padi si dhe kundërshtimet e bëra në seancat e mbjatura ka kontestuar padinë e paditëses si për nga baza ashtu edhe lartësia duke kontestuar ato si tejet të larta, ndersa sa i perket baze se kerkesepadise e kane kontestuar ne kuptimin se edhe paditesja ka kontribuar ne shkaktimin e aksidentit ne fjale.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë:

*Ekspertiza e ekspertit te lemise se komunikacionit [REDAKTUAR] e kryer per nevoja te procesit penal, oferta e te paditures nr.1970/12 dt.05.02.2013, mendimi I dr. [REDAKTUAR] dt.22.11.2012, raporti I spitalit rajonal per te ardhurat e paditeses dt.14.02.2012, mendimi dhe konstatimi I eksperteve dr. [REDAKTUAR] ortoped-traumatolog dhe dr. [REDAKTUAR] psikiater e dhene ne seancen e dates 09.08.2013, raporti I QE ne Ferizaj 29.08.2012 nr.1957, raporti I psikologes prane QMF Ferizaj a dtatave, 05.12.2012, 11.01.2013, 24.12.2013, raporti I fiziatrise prane QMF a dt.07.02.2013, raporti I ordinances per terapi fizikale dhe rehabilitim dt.05.08.2013, 15.04.2013 dhe 30.04.2013, raporti I neurologut [REDAKTUAR], raporti I specialistik I ortopedit SRF dt. 05.08.2013, raportet psiatrike pranw QMF I dt.18.01.2013, 27.12.2012 dhe 05.12.2012.*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e provave vec e vec si dhe të ndërlidhurae varura reciprokisht mes veti si teresi, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjykata në këtë çështje, në mes palëve ndërgjygjëse si kontestsuese i ka gjetur faktet (më me relevance ne zgjidhjen e drejtë te ceshtjes) lidhur me pjesën e përgjegjësise se të paditurës si dhe faktet lidhur me lartësinë e shumave të kërkuara nga paditësja në emër të dëmit material dhe jomaterial.

Faktet tjera të çështjes gjykata i kualifikojë në grupin e fakteve jokontestsuese.

Gjykata lidhur me faktin kontestues të shkallës së përgjegjësise së të paditurës,ka vërtetuar faktin se në aksidentin e datës 31.08.2012, deri te aksidenti ka ardhur për shkak të veprimeve të kundërligjshme të të siguruarit të paditurës në masën prej 80% ndërsa pjesën e kontributit prej 20% ne shkaktimin e aksidentit, i dedikohet paditëses. Këtë fakt gjykata e gjeti të vërtetuar nga ekspertiza e inxhinierit te komunikacionit ing. [REDAKTUAR] dt.26.11.2012,e kryer per nevoja te ceshtjes penale, dhe në fakt kjo ndarje e përqindjes së përgjegjësise së palëve ndërgjygjëse në shkaktimin e aksidentit te datës 31.08.2012, nuk ishte kontestsuese në mes palëve ndërgjygjëse dhe duke qenë se kemi një gjendje te tillë e pakontestuar nga palët ndërgjygjëse, gjykata i vlerëson ato si të qena dhe ne në këtë procedurë ka gjetur se mes palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestsuess fakti se e paditura kishte detyrimin dhe përgjegjësinë civile ne shkallen prej

80% dhe per kete shkalle pergjegjesie, në kuptim te nenit 173 lidhur me nenin 178 dhe nenit 940 te LMD-se, për shpërblimin e dëmit që ka pësuar paditësja si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti i datës 31.08.2012.

Mes palëve në kontest, kontestuese ishte vetëm lartësia e shumave të kërkuara nga paditësja në emër të dëmit jomaterial dhe material, për të gjitha figurat e dëmit të kërkuara, andaj me qëllim të vërtetimit të drejtë të shkallës dhe natyrës, intenzitetit, kohezgjatjes dhe pasojave të lëndimeve që ka pësuar paditësja, gjykata, me propozimin e te autorizuarit te paditeses ka nxjerrë provën me anë të ekspertimit nga ekspertët e lëmisë së ortopedise-traumatologjise Dr. [REDACTED] dhe psikiatrise Dr. [REDACTED], të cilët mendimet dhe konstatimet profesionale i kanë dhënë në seancën e datës 09.8.2013.

Sipas mendimeve dhe konstatimeve profesionale nga ekspertet e lëmisë së mjekësisë respective, është vlerësuar se si pasojë e aksidentit të ndodhur me datën 31.08.2012, paditesja ka pësuar këto lëndime:

Eksperti i ortopedisë-traumatologjisë, në mendimin e tij lidhur me natyrën e lëndimeve, hkallën e këtyre lëndimeve, intenzitetin e tyre, kohëzgjatjes dhe pasojat , ka paraqitur këtë konstatim, kur ka konstatuar se tek paditësja, si pasojë e aksidentit qe ka pesuar, ka ardhur deri te keto lendime:

*-Thyerje e pjesës së poshtme të nëngjurit të majtë (thyerje e dy malleollave), gervishtje ne regionin e krahut te djatht dhe regionit te kofshes se djathte.*

*-Ostroporozë - rrallim i ashtit të shputës dhe pjesës distal të kërcyrit.*

Lëndimet e tilla janë kualifikuar si lëndime të natyres se rëndë trupore, të cilat lëndime te paditësja kanë sjellë dëmtim të përkohshëm të shëndetit në shkallën prej 20%, e qe janë manifestuar me pas edhe me dhëmbje të intenzitetit posacerisht te larte per 30 minuta, e reduktuar me pas ne kohezgjatje prej 2 javesh ne intenzitet te mesem, ndersa me kalimin e kohes brenda vitit te pare ka kaluar ne dhimbje te intenzitetit te ultë e cila vazhdon kohe pas kohë tutje.

Eksperti ka sqaruar se per shkak te lendimeve te tilla tek pasitësja është evidente shëmtimi shkallës së lehtë i cili manifestohet në çalim në ecje, kjo për shkak të rrallimit të ashtit dhe dëmtimit të nyjës së zogut.

Gjykata, konstatimet e ekspertit te ortopedise-traumatologjise, i ka vlerësuar si profesionale dhe reale dhe si të tillë i ka faluar besimin e plote, ndaj duke patur parasysht përcaktimet profesionale mjekësore lidhur me karakteristikat e natyrës së lëndimeve trupore, intenzitetin e tyre, kohëzgjatjen dhe pasojat që kanë sjellë ato, gjykata ka vlerësuar se shumat e aprovuara në emër të figurave të dëmit jomaterial, janë kompatible me natyren dhe shkallën e lëndimeve.

Lidhur me formen e demit jomaterial, friken e perjetuar nga paditësja, gjykata përmes ekspertit te Psikiatrise Dr. [REDACTED], i cili në seancën e datë 09.08.2013, ka dhene mendimin dhe konstatimin e tij profesional mbi bazën e dokumentacionit mjekësor që gjindet në shkresat e lëndës si dhe nga intervistimi I drejperdrejt I bërë në seancë, ku me c'rast ka konstatuar se tek paditësja, me rastin e shkakitmit te aksidentit te datës 31.08.2013, ka qenë

present frika e karakterit sekundar me intenzitet lartë. Ky intenzitet ka kaluar me pas në te mesëm ne kohezgjatje prej 4 javeshme pas ne intenzitet te ulte per tre muaj. Kjo forme e demit tek paditësja është manifestuar me rikujtim te ngjarjes, pasiguri ne komunikacion, dhe pengesa gjate pjesemarrjes ne komunikacion gjykata mendimin dhe konstatimin e tille te ekspertit te psikiatrise e ka vleresuar si professional dhe real dhe sit e tille ia ka falur besimin e plote, duke i gjykuar paditeses pjeserisht shumen e kerkuar si kompatible me natyren dhe shkallen e kesaj forme te demit te pesuar.

Gjykata shumat e aprovuara i ka gjykuar paditësës bazuar në nenin 323 teLPK-së dhe neneve 185 par.3 lidhur me nenin 200 te LMD-se, ne emer te shperblimit i cili ne kete rast nuk ka qellimin qe rikthimit te te mires se demtuar tek paditesi, por se ka per qellim rivendosjen e ekuilibrit te c`rregulluar ne gjendjen shpirtore te paditeses, duke i dhene asaj nje statisfaksion moral, se dikush eshte gjetur fajtor, per prishjen e shendetit te saj, per c`gje i eshte detyruar asaj me kete forme te "shperblimit te demit".

Gjykata, për të gjitha këto forma të demit jomaterial, paditësës i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, mbi bazen e bindjes së lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor, me synim se vlerat e gjykuara paditeses kurre nuk do te mund t`ia rehabilitonin gjendjen shendetësore qe gezonte para aksidentit, por se asaj ky zhdemtim do t`i shërben si statisfaksion moral, për të mirat e që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të saj dhe ky shperblim tek ajo do te ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit në te ardhmenj në të ardhmen duke krijuar tek ajo ndjenjen e besimit per vazhdimin e jetes se metejme duke tejkualuar pengesat qe e kane detyruar ate te mos shpreh personalitetin e saj dhe perditshmerine e saj, ne aktivitetiet shoqërore, sportive, në familje e posaqërisht në punë.

Gjykata ka refuzuar kerkesen e paditeses per shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik, per faktin se per nje shpenzim te tille ka mundur gjykates t`i provohet me prova materiale-fatura, por te njejtat paditesi nuk i ka provuar ne kete procedure e nje detyre e tille bie ne barren e vet paditeses, andaj per keto arsye per kete forme te demit material eshte refuzuar kërkesëpadia si e pabazuar.

Gjykata, paditësit i ka gjykuar, ne emer te demit material, shumën prej 280.00€, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë per 28 dite dhe pjeserisht shumen prej 150.00, per ushqimin e perforcuar, duke patur parasysh natyrën e lëndimeve që ka patur paditësja, posacerisht pjesa ku i eshte thyer kember, qe per gjykatën e bëne te besueshëm faktin se paditësja doemos ka patur nevojë për ndihmen e nje personi te trete, për të kryer nevojat më elementare te jetësore dhe gjithashtu ushqimi me kalori, vitamina dhe minerale ka qene i nevojshem per te rigjeneruar qelizat ne rikuperimin dhe konsolidimin e pjesës kockore te demtuar si dhe ndrydhjet qe ka pesuar. Ketë vlerësim gjykata e mbështet në vlerësimin e saj të lirë bazuar në nenin 323 te LPK-së, kete nderlidhur me konstatimet mjeksore te eksperteve, per faktin se tani eshte notore per gjykates qe paditesja ka shfrytezuar ndihmen e personit te trete dhe se asaj I eshte dashur te konsumoj ushqim te perforcuar ndonese per keto dy kategori te kerkesave ajo nuk ka prezantuar prova material, per te deshmuar vleren e tyre, gjykata te njejtat I ka gjykuar mbi bazen e nje vleresimi te lire, duke patur per baze kosoton e punes-rrogen mesatare te punonjesit dhe kosoton e "shportes familjare" ne Kosove.

present frika e karakterit sekundar me intenzitet lartë. Ky intenzitet ka kaluar me pas në te mesëm ne kohezgjatje prej 4 javeshme pas ne intenzitet te ulte per tre muaj. Kjo forme e demit tek paditësja është manifestuar me rikujtim te ngjarjes, pasiguri ne komunikacion, dhe pengesa gjate pjesemarrjes ne komunikacion gjykata mendimin dhe konstatimin e tille te ekspertit te psikiatrie e ka vleresuar si professional dhe real dhe sit e tille ia ka falur besimin e plote, duke i gjykuar paditeses pjeserisht shumen e kerkuar si kompatible me natyren dhe shkallen e kesaj forme te demit te pesuar.

Gjykata shumat e aprovuara i ka gjykuar paditësës bazuar në nenin 323 teLPK-së dhe neneve 185 parag.3 lidhur me nenin 200 te LMD-se, ne emer te shperblimit i cili ne kete rast nuk ka qellimin qe rikthimit te te mires se demtuar tek paditesi, por se ka per qellim rivendosjen e ekuilibrit te c`rregulluar ne gjendjen shpirtore te paditeses, duke i dhene asaj nje statisfaksion moral, se dikush eshte gjetur fajtor, per prishjen e shendetit te saj, per c`gje i eshte detyruar asaj me kete forme te "shperblimit te demit".

Gjykata, për të gjitha këto forma të demit jomaterial, paditësës i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, mbi bazen e bindjes së lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor, me synim se vlerat e gjykuara paditeses kurre nuk do te mund t`ia rehabilitonin gjendjen shendetësore qe gezonte para aksidentit, por se asaj ky zhdemtim do t`i shërben si statisfaksion moral, për të mirat e që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të saj dhe ky shperblim tek ajo do te ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit në te ardhmenj në të ardhmen duke krijuar tek ajo ndjenjen e besimit per vazhdimin e jetes se metejme duke tejkualuar pengesat qe e kane detyruar ate te mos shpreh personalitetin e saj dhe perditshmerine e saj, ne aktivitetiet shoqërore, sportive, në familje e posaqërisht në punë.

Gjykata ka refuzuar kerkesen e paditeses per shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik, per faktin se per nje shpenzim te tille ka mundur gjykates t`i provohet me prova materiale-fatura, por te njejtat paditesi nuk i ka provuar ne kete procedure e nje detyre e tille bie ne barren e vet paditeses, andaj per keto arsye per kete forme te demit material eshte refuzuar kërkesëpadia si e pabazuar.

Gjykata, paditësit i ka gjykuar, ne emer te demit material, shumën prej 280.00€, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë per 28 dite dhe pjeserisht shumen prej 150.00, per ushqimin e perforcuar, duke patur parasysh natyrën e lëndimeve që ka patur paditësja, posacerisht pjesa ku i eshte thyer komba, qe per gjykaten e bëne te besueshëm faktin se paditësja doemos ka patur nevojë për ndihmen e nje personi te trete, për të kryer nevojat më elementare te jetësore dhe gjithashtu ushqimi me kalori, vitamina dhe minerale ka qene i nevojshem per te rigjeneruar qelizat ne rikuperimin dhe konsolidimin e pjesës kockore te demtuar si dhe ndrydhjet qe ka pesuar. Ketë vlerësim gjykata e mbështet në vlerësimin e saj të lirë bazuar në nenin 323 te LPK-së, kete nderlidhur me konstatimet mjeksore te eksperteve, per faktin se tani eshte notore per gjykates qe paditesja ka shfrytezuar ndihmen e personit te trete dhe se asaj I eshte dashur te konsumoj ushqim te perforcuar ndonese per keto dy kategori te kerkesave ajo nuk ka prezantuar prova material, per te deshmuar vleren e tyre, gjykata te njejtat I ka gjykuar mbi bazen e nje vleresimi te lire, duke patur per baze kosoton e punes-rrogen mesatare te punonjesit dhe kosotn e "shportes familjare" ne Kosove.


Vendimin mbi aplikimin e kamates gjykata e ka bazuar ne nenin 277 lidhur me nenin 186 te LMD-se.

Vendimin mbi shpenzimet e procedures kontestimore gjykata e ka bazuar ne nenin 452 parag.1 te LPK-se, duke ia njohur paditesit shumën prej **804.40 €**, dhe ate per perpilimin e padise dhe precizimin e saj 140.40€, per eksperte 200.00, per perfaqesim nga avokati ne tri séance 364.04€, taksen per padi dhe aktgjykim ne shume prej 100.00 €.

Andaj, gjykata bazuar ne nenin 2,5,29,142 dhe 160 te LPK-se, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.271/13 date 26.08.2013**

Gjyqtari,  
Enes Mehmeti



**Keshilla Juridike:** Kunder ktij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLICA E KOSOVES  
VENDIMI ESHTË I PLOTËFUQISHËM → CA. nr. 3062/13  
ODLUKA JE PRUVROBNA ZMA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC  
08.07 2016  
